



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova
Kuvendi - Skupština - Assembly

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, TË MBAJTUR MË
28 MARS 2008

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE
28. MARTA 2008. GODINE

Mars – Mart
2008

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare të 12, 13 dhe 14 marsit 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit të produkteve për mbrojtjen e bimëve, dhe
4. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Dnevni red:

1. Usvajanje zapisnika sa plenarnih sednica od 12. 13. i 14. marta 2008. godine,
2. Vreme za poslanička pitanja,
3. Prvo razmatranje Nacrta-zakona o proizvodima za zaštitu bilja,
4. Prvo razmatranje Nacrta-zakona za sprečavanje i integrisanu kontrolu zagađivanja.

Agenda:

1. Approval of the minutes of the plenary sessions of 12, 13 and 14 March 2008,
2. Time for parliamentary questions,
3. First reading of the Draft law on Protection Plant Products,
4. First reading of the Draft Law on integrated prevention pollution control.

Seanca filloi në orën 10,00

Seancën e drejtoi zoti Jakup Krasniqi, Kryetar i Kuvendit të Kosovës.

KRYETARI I KUVENDIT: Të nderuar deputetë, të nderuar ministra – mirë se keni ardhur në Seancën e sotme plenare të Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Konstatoj se në sallë janë të pranishëm 98 deputetë, që do të thotë se janë plotësuar kushtet për ta filluar punën.

Ju njoftoj se në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës, Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për Seancën e sotme plenare.

Rendi i ditës, së bashku me materialin e bashkëngjitur, iu është shpërndarë deputetëve.

Prandaj, fillojmë me shqyrtimin e pikave të rendit të ditës.

Pika e parë e rendit të ditës është:

- **Miratimi i procesverbaleve të seancave plenare, të mbajtura më 12, 13 dhe 14 mars 2008.**

Ju njoftoj se procesverbalet e seancave plenare të mbajtura me 12, 13 dhe 14 mars 2008, si dhe transkriptet nga këto seanca plenare, iu janë shpërndarë me kohë deputetëve.

Pyes deputetët, a kanë vërejtje në procesverbalet dhe transkriptet e këtyre seancave plenare?

Meqë nuk ka vërejtje, konstatoj se Kuvendi i miratoi procesverbalet e seancave plenare të mbajtura më 12, 13 dhe 14 mars, së bashku me transkriptet.

Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

- **Koha për pyetje parlamentare**

Ju njoftoj se, në pajtim me Rregullën 26.1 të Rregullores së Punës të Kuvendit, koha për pyetje të deputetëve për Qeverinë është e kufizuar në 50 minuta.

Në afatin e përcaktuar me Rregullore, janë parashtruar këto pyetje parlamentare:

Ju bëj me dije se, për disa pyetje, që i janë bërë Qeverisë për dhënien e përgjigjeve, Kryeministri dhe zëvendëskryeministrat nuk janë prezent sot, por këto, nëse është e mundshme, do t'i lëmë për kohën kur ata të jenë prezentë këtu.

Vazhdojmë më tej. Pyetje për Kryeministrin ka deputeti Driton Tali.

Driton, a do të pajtohesh që ta lëmë këtë për t'u përgjigjur kur të vijë Kryeministri ose zëvendëskryeministrat? Faleminderit!

Deputetja Sanije Aliaj ka pyetje për ministrin e Transportit dhe Posttelekomunikacionit, Fatmir Limaj.

Lus deputeten ta lexojë pyetjen.

SANIJE ALIAJ: I nderuar Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar ministra,
Të nderuar kolegë deputetë,
Në vitin 2003 - 2004, në vendkalimin hekurudhor te rruga e Reçakut, në Ferizaj, treni ka mbytur katër qytetarë.

Në vitin e kaluar, janë aksidentuar 3 qytetarë, prej të cilëve 2 kanë vdekur.

Vija hekurudhore, e cila kalon përmes qytetit, nuk ka barrierë mbrojtëse dhe anësorë mbrojtës në tërë gjatësinë e saj, që paraqet rrezik permanent për qytetarët.

Ky shqetësim i qytetarëve të Ferizajt, ka qenë pjesë thelbësore e debateve në zgjedhjet e fundit për kuvendin komunal dhe për atë qendror.

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Regjia, ju lutem vazhdojani mundësinë për të kryer diskutimin. Lus deputetët që pyetjet t'i lexojnë për kohën e paraparë.

SANIJE ALIAJ: Pyetja: Kur do t'i merr Ministria e Transportit dhe Posttelekomunikacionit hapat konkretë për ndërtimin e katër mbikalimeve të tipit të mbikalimit në aksin rrugor Prishtinë-Shkup, që është i vendosur në Çagllavicë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Urdhëroni, zoti ministër, fjalën e keni ju!

FATMIR LIMAJ: I nderuar Kryetar,
Të nderuar deputetë,
Zonja deputete, të falënderoj për pyetjen! Normalisht, ashtu si ju, edhe ne si Ministri dhe besoj edhe pushteti lokal e qytetarët, janë të brengosur për çdo jetë të qytetarit që mund të jetë në rrezik si rezultat i mosrespektimit të shenjave, të rregullave të komunikacionit dhe të Ligjit për siguri, e po ashtu edhe për shkak të mungesës së kushteve për qytetarët, jo vetëm në Ferizaj, por anekënd Kosovës, duke kaluar nëpër hekurudhat tona, të cilat nuk janë të mbrojtura si duhet.

Dua t'ju them se Ministria e Transportit është përgjegjëse për vendosjen e shenjave të sinjalizimit paralajmërues, të cilat vendosen para vendkalimit hekurudhor për 80, 160 dhe 240 metra, si dhe për shenjat "Stop" dhe "Kryqin e Andeut", të cilat vendosen 3 metra para vendkalimit në të gjitha rrugët rajonale dhe magjistrale. Kuptohet se është në

përgjegjësi edhe bashkëpunimi me hekurudhën edhe për ndërtimin eventual edhe të ndonjë mbikalimi apo nënkalimi për rrugët e përmendura.

Sa i përket rastit në fjalë, për komunën e Ferizajt, për ndërtimin e mbikalimeve për këmbësorë, kjo është përgjegjësi ekskluzive e Komunës së Ferizajt. Në qytetin e Ferizajt, hekurudha kalon në mesin e tij dhe aty janë dy vendkalime – rrugë dhe hekurudhë, të cilat janë të mbrojtura me gjysmëbarriera dhe sinjale elektrike të rrugës.

Vite më parë, pa pëlqimin e hekurudhave, komuna ka ndërtuar edhe një vendkalim te Fabrika e Vajit, i cili lidhë rrugën për Shtime dhe i cili ka qenë i pambrojtur deri para 3 vitesh, kur Hekurudha e Kosovës ka vendosur barriera mekanike që operohen nga punonjësit, të cilët i paguan vetë komuna.

Për fat të keq, hekurudha në qytetin e Ferizajt, është e vërsuar çdo ditë nga kalimtarët dhe, siç e dini, fatkeqësisht, nuk respektohen shenjat paralajmëruese. Duhet të them se për të gjitha vendkalimet ose mbikalimet që kanë të bëjnë me brendapërbrenda qytetit, ato nuk janë në përgjegjësinë e Ministrisë, por janë në përgjegjësi të komunës. Është Komuna ajo e cila duhet të ndërtojë këto mbikalime ose nënkalime. Padyshim se Ministria e Transportit do të jetë afër tyre për të futur në projekte të bashkëfinancimit, për ta ndihmuar pushtetin lokal për financimin e projekteve të tilla, të cilat, normalisht janë të shtrenjta dhe si të tilla, ndoshta pushteti lokal nuk ka mundësi financiarisht vetë t'i realizojë. Mirëpo, iniciativa për vetë qytetin, jo vetëm në Ferizaj, por për të gjitha qytetet e Kosovës, nëpër të cilat bie hekurudha po edhe rrugët, janë përgjegjësi e pushteteve lokale dhe në këtë rast Ministria e Transportit mund të bëjë diçka me anë të bashkëfinancimit.

Dihet se ne jemi përgjegjës për rrugët magjistrale dhe regjionale, megjithëse edhe këtu nuk qëndrojnë punët mirë. Besoj se të gjithë e dini, në rrugët magjistrale ose regjionale, nëpër të cilat kalojnë hekurudhat e Kosovës, ose në rrugët të cilat kanë banime të mëdha dhe duhet të kenë

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Lus regjinë, t'i vazhdohet mundësia për fjalë.

FATMIR LIMAJ: Mendoj se duhet ta shfrytëzoj rastin që edhe ju, si deputetë, por dhe pushteti lokal dhe të gjithë ne së bashku, duhet t'u bëjmë apel njerëzve - qytetarëve, që të mos lejojnë vjedhjen dhe grabitjen e shenjave sinjalizuese, që është duke ndodhur anekënd Kosovës, edhe në hekurudha edhe në rrugë, e sidomos në vendkalimet hekurudhore.

Këto barriera kushtojnë shumë shtrenjtë. Së paku prej 250 deri 300 mijë euro kushton një gjysmëbarrierë. Fatkeqësisht, kemi raste, në të kaluarën, që ka ndodhur vjedhja apo grabitja e këtyre shenjave, dhe kështu, në mënyrë të vetëdijshme ose të pavetëdijshme, ata njerëz - keqpërdorues që e bëjnë këtë gjë, e vejnë në rrezik jetën e qytetarëve tanë.

Prandaj, duhet t'i ftojme qytetarët që të bashkëpunojnë me policinë dhe t'i lajmërojnë këto raste, sepse këto raste ndikojnë drejtpërdrejt në sigurinë e tyre. Faleminderit!

KRYETARI: A keni pyetje shtesë lidhur me këtë? Ju lutem, përdoreni elektronikën, sepse s'jeni duke e shfrytëzuar. Urdhëroni, tani e keni fjalën!

SANIJE ALIAJ: Zoti ministër,

Pyetjen time do ta përsëris deri në atë moment kur të shohim hapat e ndërmarrë konkretë. Hekurudhat janë projekte nacionale. Në qoftë se qëndron në ligj se është kompetencë e kuvendit komunal, atëherë Ministria le të lejojë mjete financiare që në këto tri vendkalime të merren hapat konkretë, sepse mu në qendër të qytetit është shkolla më e madhe - me numër më të madh të nxënësve, që s'e ka hekurudhën as 10 metra larg dhe në anën e kundërt është shkolla "Gjon Sereçi".

Prandaj, pyetja që e kam shtruar sot, duhet të jetë shumë serioze, edhe për ju si ministër edhe për pushtetin komunal, që e udhëheq zoti Bajrush Xhemajli.

Ne këtë pyetje e bëjmë për herë të dytë. Në mandatin e dytë ka qenë e parashtruar nga Bajrush Xhemajli dhe nuk është bërë asnjë hap konkret lidhur me të. Edhe në këtë mandat, unë do ta përsëris, sepse janë në pyetje jetët e atyre, për të cilët....

(Ndërprerje nga regjia)

KRYETARI: Ju njoftoj se më nuk do të mundësohet vazhdimi i diskutimit nga regjia. Prandaj, prapë lus, pyetjet dhe përgjigjet të jenë të sakta dhe në kohën e paraparë me Rregulloren të Punës.

A keni përgjigje, zoti ministër? Fjalën e ka ministri i Transportit, Fatmir Limaj. Urdhëroni!

FATMIR LIMAJ: Më duket se po e kuptoj shqetësimin tuaj dhe e ndaj atë shqetësim tuaj, jo vetëm për Ferizajn, por edhe për shumë qytete të tjera, sikur që thashë edhe më herët.

Po e përsëris edhe njëherë. Ne jemi të gatshëm të futemi në projekte të përbashkëta me komunën e Ferizajt për të ndërtuar mbikalime dhe për të krijuar siguri të qytetarët. Unë ju siguroj se Ministria e Transportit dhe politikat e saj shkojnë në drejtim të tillë dhe parësore e kanë jetën dhe sigurinë e qytetarëve. Ju e keni parë se edhe në Ligjin për komunikacion kjo është një nga politikat tona. Prandaj, dua t'ju siguroj që, në bashkëpunim me pushtetin lokal, jemi të gatshëm të hyjmë në bashkëfinancim për të ndërtuar ato mbikalime jo vetëm në Ferizaj, por edhe në qytete të tjera dhe jo vetëm në hekurudha, por edhe në rrugët magjistrale dhe regjionale të vendit.

KRYETARI: Faleminderit! Pyetje ka edhe deputeti Bahri Hyseni. Edhe kjo pyetje e ka të njëjtin fat sikur pyetja e parë.

Pyetjen e katërt, e bën deputeti Hajredin Hyseni – PDK, për Ministrin e Mjedisit dhe të Planifikimin Hapësinor, zotin Mahir Jagcillar. Lus deputetin, ta lexojë pyetjen!

Hajredin HYSENI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Përsëritje, Kabinetit qeveritar,

Deputetë të nderuar,

Liqeni i Batllavës, është ndër liqenet më të mëdha artificiale në Kosovë. Pos rëndësisë së madhe që ka për furnizimin me ujë për pije për banorët e Prishtinës dhe qytetet përreth, ka rëndësi të madhe arsimore e turistike, për mbrojtjen, zhvillimin dhe avancimin e të cilit nuk është bërë asgjë deri më tash.

Pyetje: Zoti ministër, a ka Ministria ndonjë projekt për Liqenin e Batllavës për mbrojtjen nga ujërat e zeza që ndotin liqenin dhe për mbrojtjen e bukurive dhe të peizazheve që posedon ky liqe?

KRYETARI: Zoti ministër, fjalën e keni ju? Zoti ministër, i keni 3 minuta.

MAHIR JAGCILAR: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Zotëri deputet Hyseni,

Inspektorati i Ministrisë së Mjedisit inspekton shumë shpesh këtë pjesë për të verifikuar gjendjen dhe menaxhimin me ujëra të zeza nëpër objektet hoteliere dhe lokalitetet tjera.

Nga inspektimi i fundit, inspektorët kanë konstatuar se objektet hoteliere ujërat e zeza i derdhnin në gropa septike dhe të njëjtat, sipas deklaratave të pronarëve, sporadikisht i zbrazin në cisterna, duke i dërguar në deponinë higjieno-sanitare në Dumnicë të Podujevës.

Po ashtu, në bazë të takimeve që kanë pasur me banorët e fshatit Orllan, inspektorët kanë konstatuar se banorët e këtij lokaliteti ujërat e zeza disa i derdhnin në gropa septike, e disa edhe në rrjedhat e përroskave buzë lokalitetit, të cilat kanë mundësi të vazhdojnë në drejtim të Liqenit të Batllavës.

E njëjta situatë ishte edhe në fshatin e afërt Turiçicë dhe në lokalitetet në veri të lumit në Turiçicë, si dhe në fshatrat Bërvenik, Ballaban e më tutje – Grykës së Gollakut, në drejtim të Keqekollës.

Sa i përket ligjit, Ligji i ndalon ndërtimet e objekteve afariste ose të shtëpive në rrethin prej 500 metrash. Strategjia për trajtimin e ujërave të zeza nuk ka paraparë implant për trajtimin e ujërave të zeza, mirëpo në Ministri kemi përgatitur projektin për Konferencën e donatorëve për trajtimin e ujërave të zeza në të gjithë Kosovën, por edhe rreth Liqenit të Batllavës, për çka besojmë fuqishëm se ky projekt do të aprovohet.

Ndërsa, rreth asaj se a kemi ndonjë projekt për mbrojtjen e bukurive natyrore të Liqenit të Batllavës, Ministria, për shkak të limiteve buxhetore, nuk ka ndonjë projekt konkret,

mirëpo nuk përjashtohet mundësia që në të ardhmen të mendojmë të punojmë edhe lidhur me këtë. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! A ka pyetje shtesë? Nuk ka. Faleminderit!

Pyetja e pestë, prapë është e deputetit Driton Tali për Kryeministrin ose zëvendës-kryeministrin, të cilët nuk janë këtu dhe nëse vijnë do të përgjigjen.

Pyetje tjera? Nuk ka!

Njoftoj deputetët se nëse pyetja nuk merr përgjigje brenda dy seancave, ajo publikohet në Buletinin e Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Për fjalë është lajmëruar deputeti Driton Tali. Urdhëro, Driton!

DRITON TALI: Përshëndetje, zoti Kryetar, Përshëndetje, të nderuar deputetë dhe të pranishëm, Vetëm desha të rikujtoj se këto dy pyetjet e para kanë qenë pyetje..., në realitet e para, sepse për të dytën nuk mu dha rasti për herë të dytë.

Domethënë, nëse edhe sot nuk marr përgjigje, ngelet të publikohet dhe, nëpërmjet mjeteve të shkruara, të fillohet debati! Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Për fjalë është lajmëruar Gjylnaze Syla. Urdhëroni zonja Gjylnaze!

GJYLNAZE SYLA: Faleminderit, Kryetar!

Unë kam shtruar pyetje të mërkurën, që do të thotë se e kam plotësuar Rregullën 26 pikë 2, sipas të cilës kërkohet që pyetja të parashtrohet 48 orë para mbajtjes së seancës, prandaj kërkoj që pyetja ime të futet për sot dhe kërkoj përgjigje në pyetjen time.

Meqenëse pyetja ime i është drejtuar Kryeministrit dhe Kryeministri nuk është këtu, unë zoti Kryetar, e kisha shtruar atë pyetje.

KRYETARI: Unë ju njoftoj se pyetja juaj nuk i ka plotësuar 48 orët, prandaj në seancën tjetër do të jetë në rend dite. Do të thotë, është dorëzuar, por në orën 13 dhe nuk i ka plotësuar 48 orët që duhet t'i plotësojë për pyetje parlamentare dhe për të ardhur në parlament.

Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

- Shqyrtimi i parë i Projektligjit të produkteve për mbrojtjen e bimëve

Projektligji iu është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratim të tij, në parim.

Ftoj ministrin Idriz Vehapi, që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

IDRIZ VEHAPI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Qëllimi i këtij Projektligji është krijimi i një kornize ligjore për parimet e përgjithshme që kanë të bëjnë me vendosjen në treg dhe kontrollimin e substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, autorizimin, qarkullimin, përdorimin, mbajtjen e regjistrit dhe regjistrin e personave fizikë dhe juridikë.

Ky ligj rregullon klasifikimin, ambalazhimin dhe etiketimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve në pajtueshmëri me direktivat e BE-së.

Me këtë ligj, gjithashtu, rregullohen mbetjet e substancave aktive të produkteve për mbrojtjen e bimëve, mbeturinat e paketimeve të tyre dhe mënyra e emetimit në ambient.

Nevoja për Projektligjin

Ky projektligj, është i një rëndësie të veçantë, sepse Kosovës i mungon legjislacioni i përshtatshëm i cili i referohet vendosjes në treg të produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Projektligji ka 10 kapituj, me gjithsej 59 nene.

Në kapitullin 1, janë të përshkruara dispozitat e përgjithshme.

Në kapitullin 2, bëhet fjalë për vendosjen në treg dhe përdorimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Në kapitullin 3, janë të përshkruara procedurat e autorizimit.

Në kapitullin 4, autorizimet.

Në kapitullin 5, regjistri i produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Në kapitullin 6, shërbimet profesionale.

Në kapitullin 7, flitet për importin e produkteve dhe për mbrojtjen e bimëve.

Në kapitullin 8, autorizimet dhe detyrat e autoritetit kompetent.

Në kapitullin 9, dispozitat ndëshkimore, dhe

Në kapitullin e fundit, dispozitat përfundimtare.

Projektligji është i hartuar në përputhje me nenin 36 të Rregullores për Punën e Qeverisë të Republikës së Kosovës – Rregullorja Numër 1/2007.

Gjatë hartimit të këtij projektligji, si model bazë është marrë Ligji slloven, austriak dhe ai gjerman.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete buxhetore shtesë.

Versioni final i Projektligjit është shqyrtuar dhe përfunduar nga Grupi punues qeveritar, në përbërje:

- Zyra e Kryeministrit të Kosovës;
- Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Ministria e Financave dhe Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor;
- Ministria e Tregtisë dhe Industrisë, dhe
- Ministria e Shëndetësisë.

Projektligji është në harmoni me legjislacionin e BE-së, prandaj të nderuar deputetë, ju thërras ta përkrahni, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Sipas radhës, fjalën e merr kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, zoti Ramë Buja.

RAMË BUJA: Zoti Kryetar, për këtë ligj do të flasë zonja Elheme Hetemi.

KRYETARI: Atëherë, fjalën e ka deputetja Elheme Hetemi.

ELHEME HETEMI: Faleminderit, Kryetar!

I nderuari Kryetar,

Të nderuar ministra,

Të nderuar deputetë,

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, pasi e ka analizuar Projektligjin për produktet për mbrojtjen e bimëve, ka vlerësuar se është një Projektligj mjaft përmbajtësor dhe rregullon një fushë të rëndësishme. Si të tillë, Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, këtë projektligj e përkrah, në parim. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Ju njoftoj se tani e tutje, shëf i Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike është deputeti Lutfi Haziri. I uroj sukses në punë dhe përgjegjësinë që e ka marrë lidhur me këtë. Pra, fjalën e ka deputeti Lutfi Haziri.

LUTFI HAZIRI: Faleminderit, zoti Kryetar, faleminderit për mbështetjen!

Në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së për leximin e parë të Projektligjit, do të flasë profesoresha Pantina. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Fjalën e ka deputetja Myrvete Pantina.

MYRVETE PANTINA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

I nderuar zotëri Kryetar i Kuvendit,

Të nderuar ministra dhe të nderuar kolegë deputetë,

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar Projektligjin për produktet për mbrojtjen e bimëve dhe ka vendosur që në parim ta miratojë këtë projektligj, sepse mendojmë që ky projektligj është i nevojshëm për krijimin e infrastrukturës së përshtatshme ligjore për çështjet që kanë të bëjnë me produktet për mbrojtjen e bimëve në nivel sa më të avancuar.

Vlen të ceket se për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete buxhetore shtesë, por të hyrat, që do të realizohen nga gjrobat për moszbatimin e këtij ligji, do të derdhen në buxhetin e Kosovës.

Kontributin tonë lidhur me këtë projektligj do ta japim edhe në kuadër të komisioneve përkatëse. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit deputete! Në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, fjalën e ka Hestet Cakolli.

HESET CAKOLLI: I nderuar, zotëri Kryetar i Kuvendit të Republikës së Kosovës,
Të nderuar ministra,
Të respektuar kolegë deputetë,
Projektligji për mbrojtjen e bimëve ka për qëllim të rregullojë klasifikimin, testimin, paketimin, etiketimin, evidentimin dhe tregtimin e produkteve për mbrojtjen e bimëve në pajtueshmëri të plotë me direktivat e Bashkimit Evropian, ndërsa synim i fundit i këtij projektligji është mbrojtja e shëndetit të bimëve.

Ky projektligj është i hartuar sipas teknikës juridike bashkëkohore dhe është i shtjelluar në 10 kapituj dhe ka gjithsej 59 nene.

Edhe përkundër disa vërejtjeve të përgjithshme dhe konkrete, që kemi në këtë projektligj, Grupi Parlamentar i Aleancës Kosova e Re, në parim është pajtuar që ky projektligj të procedohet në komisionet përkatëse për shqyrtim të mëtutjeshëm, por gjithnjë duke rezervuar të drejtën që vërejtjet dhe sugjerimet tona t'i japim gjatë fazës së shqyrtimit të këtij projektligji. Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti deputet! Radhën e ka shefi i Grupit Parlamentar të AAK-së, deputeti Ardian Gjini.

ARDIAN GJINI: Faleminderit, zoti Kryetar!
Ky është ligj që është shqyrtuar disa herë më parë dhe çështja, e cila nuk është thënë këtë herë as prej ministrit dhe çështja e cila nuk është trajtuar mirë në Projektligj, mendojmë ne, që prapë ka hapësirë për përmirësim – është ajo se në Kosovë prodhohen shumë pak, mos të them, edhe fare, produkte për mbrojtjen e bimëve. Nëse shkon në cilëndo barnatore bujqësore, do të shihni se 90% e prodhimeve vijnë prej vendeve fqinje. Prandaj, ky projektligj është dashur të merret më tepër me importin e produkteve për mbrojtjen e bimëve për shkak se të gjitha importohen. Do të thotë, ne nuk i prodhojmë këto.

Sidoqoftë, ky është një ligj i vlefshëm dhe ligj i cili i duhet Kosovës, por mendoj se edhe ka qenë dashur që ministri të merret me këto elemente dhe jo të procedohet ashtu siç është bërë, për shkak se ka pasur probleme edhe më parë.

Ne, si Grup Parlamentar, në parim e përkrahim aprovimin e një ligji të këtillë, mirëpo mendoj se komisionet do të kenë shumë punë rreth këtij ligji. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, shefi i Grupit, deputeti Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Si Grup Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Dardanisë ne i japim mbështetje parimore këtij projektligji dhe e konsiderojmë si të nevojshëm, sepse kjo sferë e qarkullimit dhe vendosjes në treg të produkteve dhe substancave aktive për mbrojtjen e bimëve, duhet të rregullohet me ligj.

Ajo që ne, si Grup Parlamentar, e adresojmë si vërejtje në kuadër të këtij projektligji, e kemi parasysh se natyra e këtij projekti demonstroi një qasje më eksplicite të këtyre dispozitave ligjore. Prandaj, shumë dispozita janë përsëritur në kuadër të këtij Ligji. Nga ana e natyrës të kësaj materie shihet qartë se ky Ligj është mjaftë vuliminoz, prandaj është një vërejtje që nuk është dashur të përsëritet.

Ne, si Grup Parlamentar japim mbështetje parimore, duke konsideruar se është e nevojshme të rregullohet kjo sferë mjaftë e rëndësishme dhe të vendoset në kuadër të ligjit, qarkullimi dhe vendosja në treg e substancave aktive dhe e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Prandaj, si Grup Parlamentar japim mbështetje parimore. Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit! Në emër të Grupit “7+”, deputeti Sadik Idriz.

SADIK IDRIZ: Hvala, gospodine predsedniče!

I Parlamentarna grupa „7+“ u načelu podržava ovaj Nacrt zakona sa nekoliko primedbi. Najprije, u memorandumu objašnjenja koji se daje, na ovaj Nacrt zakona radila je radna grupa i navodi se sastav radne grupe: Kancelarija premijera i određena ministarstva i nevladine organizacija, ali ne imena ljudi koji su radili. Mislim da je potrebno da se vidi ko su ti ljudi koji su radili Nacrt zakona sa imenima da bi znali od prilike koji je sastav i opšte kvalifikacije, stručnost ljudi koji su radili ovaj Nacrt zakona.

Ovaj Nacrt zakona je sponzorisano od strane Ministarstva za poljoprivredu i seoski razvoj, mada će još druga neka ministarstva biti uključena, naročito u donošenju podzakonskih akata kada bude ovaj Nacrt zakon usvojen. Tu je pre svega Ministarstvo za zdravstvo, Ministarstvo za prostorno planiranje i sredinu i još neka druga. I mislim da bi u ovoj fazi, nakon usvajanja, očekujem da će biti danas usvojen u načelu, da i Komisija za zdravstvo bude uključena u razmatranju ovog Nacrta zakona, možda još neka druga komisija. Pošto se u nekoliko članova pominje ova Komisija, odnosno Ministarstvo zdravstva i druga ministarstva, nešto što pada u oči jeste da u završnim odredbama stoji da je određeno ministarstvo u obavezi da u roku od 3 godine donese podzakonska akta. Mislim da su 3. godine zaista period koji nije baš pohvalan da se naznači da će u periodu od 3. godine biti doneta podzakonska akta, jer mislim da je to dug period.

Grupa „7+“ će u načelu podržati ovaj Nacrt zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka kryetari i Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Poštovani gospodine predsedniče,
Poštovane kolege,

Parlamentarna grupa SLS je razmotrila Nacrt ovog zakona sa pravnim savetnicima i s obzirom da su ustanovili da je veći deo usaglašen sa zakonima evropskih zemalja, što je i sam ministar pomenuo, smatramo da bi bilo dobro doneti ovaj zakon. Mi podržavamo u načelu ovaj nacrt zakona, naravno podržaćemo i sve amandmane i odredbe koje mogu poboljšati tekst ovog nacrta zakona. Hvala!

KRYETARI: Faleminderit!

Pasi nuk ka të paraqitur për diskutim nga ana e deputetëve, lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.

Votojmë tash:

Konstatohet se me 75 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim,

Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin e produkteve për mbrojtjen e bimëve.

Në bazë të rregullave 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi,
3. Komisionin për Buxhet dhe Financa dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se 2 muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t’ia paraqesin raportin me rekomandime.

Sipas radhës, pika e katërt e rendit të ditës>

- **Shqyrtimi i parë i Projektligjit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes**

Projektligji u është shpërndarë deputetëve dhe janë përmbushur kushtet për shqyrtimin dhe miratimin e tij, në parim.

Ftoj ministrin për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, zotin Mahir Yagcilar që në emër të Qeverisë së Kosovës, para deputetëve të Kuvendit të prezantojë Projektligjin.

MINISTRI MAHIR YAGCILAR: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar deputetë,

Të nderuar ministra,

Kam kënaqësinë që para jush të paraqes Projektligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Një ndër politikat kryesore në fushën e mbrojtjes së mjedisit janë: parandalimi, zvogëlimi dhe, për aq sa është e mundur, eliminimi i tërësishëm i ndotjes nëpërmjet intervenimit në vend.

Qëllimi i këtij ligji është arritja e parandalimit dhe kontrollit të integruar të ndotjes, e cila vjen si pasojë e veprimtarive në industrinë energjetike, prodhimin dhe përpunimin e metaleve, industrinë e mineraleve, industrinë kimike, menaxhimin e mbeturinave, aktivitetet minerare dhe aktivitetet e tjera.

Ky projektligj kontrollon dhe parandalon ndotjen e integruar të mjedisit, duke krijuar sistemin e dhënies mjedisore për pajisjet dhe aktivitetet që mund të kenë ndikim negativ në shëndetin e njeriut apo në të mirat materiale.

Për të zhvilluar veprimtarinë e tij në pajisjet e caktuara, operatori është i detyruar të nxjerrë lejen e integruar mjedisore nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor. Nxjerrja e lejes mundëson punën e pajisjeve të reja, punën e afatizuar për pajisjet ekzistuese jo më shumë se 10 vjet për një apo disa pajisje të vendosura në vendin e njëjtë të cilat i udhëheq i njëjti operator.

Të nderuar deputetë,

Në përbërjen e legjislacionit të Bashkimit Evropian njëra nga Direktivat kyçe të Këshillit të Evropës ishte Direktiva 96 e EC-së, datë prej 24 shtator 1997 për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes ku janë dhënë masat në mënyrë të përgjithshme në BE, për arritjen e qëllimit për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Harmonizimi i legjislacionit të Kosovës me Direktivën e Bashkimit Evropian për IPPC-në kërkon një përfshirje të gjithmbarshme të detyrimeve të cilat Direktiva i shtron për shtetet anëtare në Bashkimin Evropian, si dhe shtetet që pretendojnë anëtarësimin në BE.

Projektligji përmban preambulën, 5 krerë, 23 nene dhe 4 anekse.

Me legjislacionin i cili ishte në fuqi në Kosovë, kjo fushë nuk ka qenë e rregulluar. Ky ligj do ta rregullojë këtë fushë sipas rregullave të përcaktuara nga Bashkimi Evropian.

Për zbatimin e këtij projektligji nuk nevojiten mjete shtesë buxhetore. Duke ju falënderuar për interesimin e treguar dhe duke besuar që vërejtjet, sugjerimet nga ana e juaj këtë projektligj do ta bëjë edhe më të kompletuar për implementim, ju përshëndes të gjithëve.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit, zoti ministër!

Në radhë janë kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Nga Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës, fjalën e ka deputetja Selvije Halimi.

SELVIJE HALIMI: Faleminderit, i nderuari Kryetar!

Të nderuar deputetë,
Të nderuar ministra,

Projektligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, në një formë plotëson infrastrukturën ligjore rreth përkujdesjes dhe mbrojtjes së mjedisit në Kosovë dhe është njëri prej projektligjeve që në veçanti do të kërkojë një zbatim rigoroz nga institucionet qeverisëse, gjegjësisht nga aktivitetet e ndryshme të komunitetit, me qëllim të parandalimit apo të izolimit të ndotësve të caktuar në mjedis dhe do të krijojë kushte për një shëndet më të mirë publik për popullatën.

Deri më tash nuk mund të themi se kemi pasur një zbatim të mirë të ligjeve të cilat kanë qenë në fuqi. Kompletimi me infrastrukturë ligjore kërkon, në rend të parë, një zotim qeveritar për implementimin e tyre nga të gjithë resorët, duke ditur se çdo aktivitet që i mbulon resorët e caktuar qeveritar, fjalën e fundit duhet ta marrë nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, me qëllim të ruajtjes së mjedisit dhe të komponentëve të tij.

Grupi Parlamentar i PDK-së, duke parë rëndësinë e këtij projektligji, e përkrah në parim dhe kontributin e vet për plotësimin e tij do ta japë në komisionin gjegjës.
Faleminderit!

KRYETARI: Faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike, fjalën e ka deputeti Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: I nderuar Kryetar,
Të nderuar deputetë,

Projektligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, i propozuar nga Ministria për Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, dhe i mbështetur e i miratuar me vendim të Qeverisë numër 13/9 të datës 17.02.2008, është i një rëndësie të veçantë, duke marrë parasysh qëllimin e këtij projektligji me të cilin do të rregullohet një çështje shumë e rëndësishme për jetën e qytetarëve të republikës së Kosovës, e cila ka qenë po thuaj se e pakontrolluar, siç është parandalimi dhe kontrolli i integruar i ndotjes në mjedisin ku jetojmë. Zhvillimi shoqëror ekonomik në Kosovë është më se i domosdoshëm, por krahas kësaj duhet të ketë kontroll të rregulluar me ligj të veprimtarive të cilat shkaktojnë ndotje, siç janë: industritë energjetike, përpunimi i metaleve, industritë kimike, aktivitetet minerale, menaxhimi i mbeturinave, përpunimi i drurit, etj.

Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e ka shqyrtuar me kujdes këtë projektligj, i cili është hartuar konform dispozitave ligjore dhe është harmonizuar me Direktivat e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes,

me të cilin përmbushen edhe kriteret e kërkuar nga Acquis Communautaire duke rregulluar procedurat e dhënies së lejeve mjedisore për pajisjet dhe aktivitetet të cilat ndikojnë negativisht në mjedisin dhe shëndetin e qytetarëve tanë.

Si të tillë, Grupi Parlamentar i Lidhjes Demokratike të Kosovës e mbështet, në parim, duke i sugjeruar komisionit funksional që së bashku me ekspertët e kësaj fushe të rregullojë në mënyrë të veçantë në aneksin, në shtojcën e aktiviteteve pasi që ky projektligj si bazë ka marrë Direktivat e BE-së dhe IPPS-së, si dhe nga legjislacioni sloven dhe gjerman, t'i rregullojë, duke precizuar në aneks-shtojcën: aktivitetet, pragun e kapacitetit, pragun e shkarkimit dhe pragun e prodhimit të përpunimit apo përdorimit. E gjitha kjo vlen nga Komisioni Ekonomik për Evropën nga një takim i jashtëzakonshëm i cili është mbajtur në Kiev, më datë 21 maj 2003 dhe nga aty ka dalë Konventa për të Drejtën e Informimit, Pjesëmarrjen Publike në Vendimmarrje dhe Drejtësinë lidhur me problemet mjedisore.

Prandaj, është shumë me rëndësi për të gjithë të bëhet identifikimi i saktë i ndotësve në ambientin ku jetojmë.

Ju faleminderit për vëmendje!

KRYETARI: Faleminderit!

Fjalën e ka deputetja e Grupit Parlamentar të AKR-së, Njomza Emini.

NJOMZA EMINI: Faleminderit, zoti Kryetar!

Të nderuar ministra,

Kolegë deputetë,

Projektligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes së ambientit, Grupi Parlamentar i AKR-së e ka shqyrtuar me vëmendje. Siç dihet, Kosova është ndër vendet e rralla me ndotje kaq të madhe të ambientit, me gjithë faktin se nuk ka industri të rëndë.

Ligji në fjalë, edhe pse merret me parandalimin dhe kontrollimin e integruar të ndotjes së mjedisit, nëpërmjet dhënies së lejes mjedisore integruese për pajisjet dhe aktivitetet që ndikojnë në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, ai megjithatë le hapësirë të madhe kohore gjer në vitin 2017 për të vënë në kontroll impiantet ekzistuese, që janë ndotësit më të mëdhenj të ambientit në Kosovë, e që tejkalojnë për disa herë standardet ndërkombëtare.

Hapësira kohore që është dhënë deri në fillim të implementimit të këtij ligji, si dhe krijimi i akteve nënligjore, duhet të jetë shumë më e shkurtër për të penguar ndotjen e mëtejme të mjedisit.

Grupi Parlamentar i AKR-së, duke kuptuar rëndësinë e këtij ligji, do të jetë në përkrahje të vazhdueshme, jo vetëm gjatë fazë së amendimit, por edhe në fazën e implementimit të tij.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Në emër të Grupit Parlamentar AAK-së, shefi i Grupit, Ardian Gjini!

ARDIAN GJINI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Paramendoni nëse unë tash them se nuk e përkrah këtë ligj, nuk vjen në shprehje. Edhe Grupi Parlamentar i Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës e mbështet ligjin.

Mendoj se ministri ka qenë dashur të na japë edhe disa sqarime për shkak se do të ketë provizione të cilat dyfishohen, do të thotë të legjislacionit ekzistues për Mjedis edhe të këtij projektligji. Ky projektligj është i domosdoshëm, mirëpo ka qenë dashur të na thuhet se cilat janë ato ligje ekzistuese. Cila është ajo pjesë e legjislacionit ekzistues e cila duhet të amendohet, pasi që ky ligj të hyjë në fuqi. Kjo është e para, edhe e dyta, një sugjerim, domethënë ministri bën politikë, e sjell një ligj në të cilin Ministria ka punuar për më tepër se një vit. Pra, ligji nuk është roman as libër publicistik që t'u jepet njerëzve për të shtuar ujë dhe mill, çka të donë. Ministri duhet ta mbrojë ligjin qysh e ka pru. Është pjesë e punës sonë si Kuvend për ta ndryshuar, por ministri duhet ta mbrojë ligjin qysh e ka pru, jo të thotë sugjeroni çka të doni ju edhe bëjeni ligjin qysh të doni, për shkak se është menduar gjatë, administrata ka menduar gjatë për këtë projektligj.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit edhe për sugjerimet që i dhatë.

Në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së,
shefi i Grupit, Lulzim Zeneli.

LULZIM ZENELI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Grupi ynë parlamentar e përkrah, në parim, miratimin e këtij ligji, duke konsideruar se vendosja në një sistem ligjor e procedurës së dhënies së lejeve është me rëndësi të madhe, duke pasur një kontroll në aspektin e ndotjes dhe, gjithmonë duke pasur në konsideratë vendosjen e një kontrolli ligjor lidhur me ndotjen e mjedisit.

Ajo çka proklamohet apo është vullnet qeveritar për të përmirësuar gjendjen, në aspektin e ndotjes apo përmirësimit të gjendjes aktuale, të ndotjes mjedisore dhe ajo çka sot përshkruhet me dispozitat ligjore të këtij projektligji dhe gjendja ekzistuese çka është reale, është një diskrepancë e madhe.

Kolegia pak më herët i përshkroi periudhat kohore, kur fillon të implementohet ky projektligj, për të gjitha këto kapacitetet industriale ekzistuese, që është mjaft diskriminues, me çdo iniciativë të re që parashikohet të merret sot apo nesër. Prandaj, kjo periudhë kohore nuk inkurajon përmirësimin e gjendjes që sot është alarmante sa i përket ndotjes së mjedisit në vend.

Konsiderojmë se edhe pse qëllimi i këtij projekti apo krijimi i kësaj infrastrukture ligjore ka për synim vendosjen e një parimi të qëndrueshëm, të qëndrueshmërisë ndërmjet zhvillimit ekonomik, mbrojtjes së mjedisit dhe mirëqenies sociale, dhe ajo çka është shumë me rëndësi sot, vendosjen e parimit që ndotësi do të gjobitet, ndotësi

do të paguajë, ky projekt nuk inkurajon një sistem të tillë, nuk inkurajon një qëndrueshmëri të tillë afatgjate.

Ne, si Lidhje Demokratike e Dardanisë, si Grup Parlamentar, e përkrahim në parim, mirëpo grupit apo komisionit parlamentar i mbetet shumë punë, në mënyrë që ky projekt në të ardhmen të jetë funksional.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar "7+", deputeti Enis Kervan.

ENIS KERVAN: Ju faleminderit, zoti kryetar!

Të nderuar ministra dhe deputetë,

Me këtë ligj, besojmë që do të rregullohet kjo fushë, e cila deri më tani nuk ka qenë e rregulluar, prandaj Grupi Parlamentar "7+", në parim e përkrah këtë projektligj, i cili është i rëndësishëm për Republikën e Kosovës dhe kontributin e tij do ta japë në komisione.

Ju faleminderit.

KRYETARI: Ju faleminderit!

Në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, deputeti Bojan Stojanović.

BOJAN STOJANOVIĆ: Parlamentarna grupa je u načelu razmatrala Nacrt zakona, i s obzirom da Zakon tretira oblast na koju poseban akcenat daje i Evropska Unija, i samim tim dobili smo informaciju od ministra da je Zakon u načelu usaglašen sa zakonima Evropske Unije, mi smatramo da je potrebno da podržimo ovaj Zakon, u načelu. Naravno, kroz komisiju ćemo pokušati da amandmanima na odredbe poboljšamo ovaj zakon, čija će implementacija doprineti i boljem kvalitetu zakona. Hvala!

KRYETARI: Ju faleminderit!

Sipas radhës, fjalën e ka deputeti Hydajet Hyseni -Kaloshi

HYDAJET HYSENI-KALOSHI: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Zonja e zotërinj deputetë,

Të nderuar ministra,

I nderuar ministër Yagcilar,

Si deputet, nuk mund të mos ndjehesh mirë kur ke mjaft kohë për të debatuar për një ligj ose për ligjet, edhe pse sot kemi shumë kohë, e pak ligje, për dallim nga ndonjë rast më parë, kur kishim shumë ligje shumë të rëndësishme, dhe hiq kohë. Megjithatë, unë dua ta përshëndes nismën për ta rregulluar me ligj edhe këtë çështje, po ashtu të rëndësishme dhe, do të thosha, me rëndësi të shtuar pas asaj që ndodhi në Prishtinë, e që po ndodhë edhe në fqinjësi. Është mirë që është një ligj për parandalimin e së keqes para se të ndodhë ajo në përmasa çfarë mund të ndodhë.

Megjithatë, unë dëshiroj të tërheq vërejtjen në një fenomen në këtë ligj, që ligji rregullon një çështje, e cila pastaj, praktikisht është e bartur në Aneks, kurse në Aneks, domethënë si metodologji më duket pak e pazakonshme. Në Aneks keni ndër destinimet kryesore Rafinerinë në shqip “të vajgurit”, në serbisht është “të gazit,” kurse në anglisht “oil”.

Së pari, për mua ishte lajm i mirë kjo që ne kemi rafineri, por nuk e di a e kemi, vërtet, apo çka është puna me ato rafineri? Dhe, e dyta, a është fjala për gaz, a për vajguri, apo për oil, që është karburante, ndryshe.

Dua ta shfrytëzoj këtë fakt për të tërhequr vërejtjen në dy fenomene. Ligjet ne nuk mund t’i shpikim gjithmonë, natyrisht që do të marrim edhe përvojën e vendeve të tjera. Por ka rëndësi, zonja dhe zotërinj, që ligjet t’ua përshtatim kushteve tona specifike dhe, e dyta, aman, harmonizimin gjuhësor, sepse ne po debatojmë, po shqyrtojmë, po vendosim në shqip, por ju e dini që me Rregulloren tonë, në fakt mbetet ajo që është në anglisht. Prandaj, po na ndodh që ne vendosim, votojmë në të vërtetë “për lisa”, por në të vërtetë, atje vendoset “për fshesa”, vendosim këtu për gaz ose vajguri, por, në të vërtetë, atje kemi vendosur për diçka krejt tjetër. Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit!
Fjalën e ka deputeti, Riza Smaka.

RIZA SMAKA: I respektuar Kryetar i Kuvendit,
Ministra të Qeverisë të Republikës,
Deputetë të Kuvendit të Republikës,

Me qëllimin më të mirë që të ofroj një kontribut sado të vogël në funksion të bërjes së këtij ligji sa më të mirë, ndryshe shumë të dobishëm, shumë të nevojshëm dhe mundësisht sa më parë që do të ishte e mundur të miratohet dhe aplikohet, do t’i kisha dhënë disa sugjerime parimore.

Në hyrje, kudo, prandaj edhe në këtë ligj, do të duhej që të jepet fillimisht Ligji, me Ligjin për parandalimin dhe kontrollimin e integruar të ndotjes, (Ligji) dhe më pastaj, të thuhet:

Neni 4 përmban një materie që është krejtësisht e aktit juridik nënligjor, prandaj, do të duhej që ligji të jetë sa më i zbarkuar nga ato temat të cilat do të duhej lënë Ministrisë dhe ministrave tanë, në mënyrë që të kenë fushë të veprimit, se këto mund të ndryshohen shpejt edhe më pastaj del se duhet ndryshuar, plotësuar ligji që është procedurë më e ndërlikuar dhe e kushtuar. Prandaj, është çështje e Rregullores, ministri prej rasti në rast do ta plotësonte, do ta ndryshonte.

Neni 9, ju lutem, thotë: “ Ministria duhet të ketë parasysh parimet”. Ministria është ekzekutivi, Ministria, ligjet, jo t’i ketë parasysh, por t’i zbatojë. Ai është imperativ, aty nuk ka kurrfarë kompromisi. Detyra themelore e ministrit, e ministrave, e Ministrisë, e Qeverisë është zbatimi konsekuent i ligjeve.

Në nenin 9 është prekur çështja neuralgjike te administrata në përgjithësi. Kemi shumë raste, shpesh raste që nuk e vendos organi i administratës, në këtë rast, bie fjala, Ministria çështjen juridike administrative fare nuk e vendos ose me vite nuk e vendos. Nuk ka instrumente, janë do instrumente në Ligjin e përgjithshëm për procedurat administrative, por nuk kanë sanksione. Ju lutem, duhet medoemos të fiksohet, të specifikohet afati prekluziv. Ministria e vendos çështjen, bie fjala në afat, në mënyrë që t'i jepet bazë dhe autorizim palës së pakënaqur që të procedojë më tutje.

Në nenin 21, thuhet “me gjobë”. Nuk është fjalë e përshtatshme, nuk është fjalë shqipe. Në vend që të thuhet: “me gjobë dënohet” etj., të thuhet: “dënohet me të holla”. Është fjalë e huaj. Edhe atë që e tha kolegu i nderuar, Hyseni, gjuhët janë çështje neuralgjike në këtë ligj, qoftë gjuha shqipe, qoftë serbishtja, boshnjakishtja dhe anglishtja, sepse nuk përputhen ndërmjet veti. Pastaj ka tekste, dispozita që, jo vetëm që nuk përputhen gjuhësisht, por as përmbajtësisht. Prandaj, ky do të ishte një apel për Qeverinë që të bëjë atë çka mund ta bëjë që ligji bazë, nëse konsiderohet bazë në anglisht, të jetë me të vërtetë adekuat edhe në gjuhët e tjera.

Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit! Po, shpresoj se në komisione do të rregullohen, përmirësohen gabimet. Fjalën e ka deputetja, Gjylnaze Sylja!

GJYLNAZE SYLA: Ju faleminderit, zoti Kryetar!

Gjendja e tanishme e mjedisit dhe e ndotjes së ambientit në Kosovë është shqetësuese. Në fakt, para se të flasim për Ligjin, duhet kuptuar se ambienti është një tërësi dhe se ndotësit nuk mund të kufizohen, por udhëtojnë nga një segment në tjetrin. Prandaj, edhe aktivitetet ekonomike të njeriut, sidomos ato industriale, mund të shkaktojnë rritjen e dukshme të ndotjes së ambientit, e cila do të ketë menjëherë efekte negative në vet shëndetin e njeriut. Prandaj, atë çka synon Projektligji për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, është pikërisht që të formojë një sistem rregullator që ka qasje të integruar në kontrollimin e efekteve të aktiviteteve industriale të caktuara, menaxhimin e mbeturinave, aktivitetet e tjera, mbikëqyrjen.

Ajo, pra, përfshin përcaktimin e kontrollove adekuate për industrinë për të mbrojtur ambientin nëpërmjet një procesi të vetëm të dhënies së lejes mjedisore të integruar.

Janë të përshkruara kushtet se si duhet të fitohet leja mjedisore e integruar dhe aktivitetet, të cilat janë të përshkruara, janë të njohura, se këto aktivitete të atyre që aplikojnë duhet të kenë të zhvilluar sistematikisht propozimin për aplikim, teknikat më të mira të mundshme dhe t'u përgjigjen kërkesave të tjera duke marrë parasysh faktorët lokalë relevantë.

Po ashtu, janë të përfshira kushtet për të siguruar pajtueshmërinë me vlerat kufitare të misionit, që domethënë se niveli ose përqendrimi i misioneve të veçanta nuk lejon të tejkalohet.

Për arritjen e qasjes së integruar, Projektligji parasheh konsultimin edhe me autoritete të tjera, siç është: me autoritetin lokal, Agjencinë e Kosovës për Mbrojtjen Mjedisit, Autoritetin për Parandalimin e Aksidenteve Mjedisore dhe autoritetet e tjera.

Po ashtu, ligji nuk ka implikime buxhetore shtesë. Janë paraparë dispozitat ndëshkuese. Është në pajtim me parimet e legjislacionit evropian dhe synon t'i harmonizojë parimet me Direktivën Evropiane 9661 për Parandalimin dhe Kontrollin e Integruar të Ndotjes.

Megjithatë, dëshiroj të përmend disa mangësi të këtij projektligji. Konsideroj se në dispozitat e përgjithshme është dashur të parashihen ose të përfshihen parimet bazë, siç janë: parimet për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes, si parim i parandalimit, parimi - ndotësi paguan, parimi i integritetit dhe i koordinimit, i zhvillimit të qëndrueshëm, i informimit të publikut.

Gjithashtu, është dashur që në dispozita të parashihen përgjegjësitë dhe detyrat e inspektorëve, gjë që do të siguronte rolin mbikëqyrës të qartë. Po ashtu, është dashur të parashihen ndëshkimet e zyrtarëve, të cilët nuk u përmbahen obligimeve të parapara me ligj. Për shembull, në qoftë se zyrtari jep lejen pa përmbushjen e kërkesave të parapara me ligj, nëse nuk bën revizionin e lejes, etj. Njëra ndër vërejtjet e fundit është se në nenin 16, ku parashihet se Ministria duhet të nxjerrë një udhëzim administrativ, gjegjësisht tarifat për aplikimin për leje, mendoj se ky akt nënligjor është dashur të definohet për cilën periudhë kohore, për të cilën propozoj që të jetë 3 muaj.

Prandaj, në parim e votoj këtë projektligj, duke shpresuar se do të merren parasysht vërejtjet të cilat i dhashë.
Ju faleminderit!

KRYETARI: Ju faleminderit, deputete!

Nuk kemi deputetë të tjerë të paraqitur për diskutim. Në vazhdim, kërkoj nga deputetët që të deklarojnë për miratim, në parim, të projektligjit dhe lus ata që janë këtupari, por nuk janë në sallë, të kthehen në sallë, për votim.

Lus regjinë dhe deputetët të përgatiten për votim.
Votojmë tash:

Konstatohet se me 85 vota “për”, asnjë “kundër” dhe asnjë abstenim, Kuvendi miratoi, në parim, Projektligjin për parandalimin dhe kontrollin e integruar të ndotjes.

Në bazës të rregullave 23.7 dhe 35.4 të Rregullores së Punës së Kuvendit, Kuvendi ngarkon këto komisione:

1. Komisionin për Bujqësi, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, si komision funksional dhe referues,
2. Komisionin për Buxhet dhe Financa,
3. Komisionin për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe
4. Komisionin për Komunitete.

Komisionet duhet që në afatin, jo më vonë se dy muaj nga shqyrtimi i parë, Kuvendit t'i paraqesin raportet me rekomandime, sipas Rregullës 35. 6.

Me këtë votim, në parim, mbyllet seanca e sotme plenare.
Mirupafshim, në seancën e radhës!

E përgatiti:

Njësia e Transkripteve e Kuvendit të Kosovës